



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 144

Tiranë – E martë, 5 gusht 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 476, datë 31.7.2025	Për autorizimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare për koordinimin e procesit të konsolidimit të pronave shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi me interes publik e zhvillimor..... 20135
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 18, datë 11.7.2025	Për organizimin dhe zhvillimin e sesionit të dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2025 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025..... 20137
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 19, datë 28.7.2025	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë të sesionit të dytë, viti shkollor 2024–2025..... 20138
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 482, datë 31.7.2025	Për delegim kompetence..... 20139
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 483, datë 31.7.2025	Për delegim kompetence..... 20139
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 4.6.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.3.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë..... 20140
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 201, datë 29.7.2025	Për delegim kompetencash..... 20148
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 215, datë 1.8.2025	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 20148

**VENDIM****Nr. 476, datë 31.7.2025****PËR AUTORIZIMIN E KORPORATËS SË
INVESTIMEVE SHQIPTARE PËR
KOORDINIMIN E PROCESIT TË
KONSOLIDIMIT TË PRONAVE
SHTETËRORE ME INTERES PËR TË
REALIZUAR PROJEKTE INVESTIMI ME
INTERES PUBLIK E ZHVILLIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 5, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, në përputhje me objektivat e saj, me qëllim identifikimin e konsolidimit e pronës shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi, ngarkohet për përmbushjen e detyrave të mëposhtme:

a) Ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet procedurale për konsolidimin e pronës shtetërore në zonat/njësi territoriale, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe ministrinë përgjegjëse për ekonominë, ministrinë dhe institucionet/entet publike, që i kanë në përgjegjësi administrimi pronat;

b) Koordinon dhe bashkërendon me institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të përfshira në çështjet e pronësisë, apo të administrimit të këtyre pronave, për dhënien e shkëmbimin e informacionit, apo të dokumentacionit të kërkuar, lidhur me të drejtat e pronësisë, që është i nevojshëm për një pasqyrë të gjendjes

pronësore, caktimin më të saktë të kufijve të zonës dhe përfundimin me prioritet të procesit të regjistrimit të pronës në regjistrat e pasurive të paluajtshme;

c) Harton dhe siguron, në bashkëpunim me institucionet publike të planifikimit, zhvillimit të territorit dhe zhvillimit strategjik, projekte zhvillimi të pronave shtetërore në zonat/njësitë territoriale, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Institucionet shtetërore të përfshira në çështjet e pronësisë, apo të administrimit të pronave, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, duhet të paraqesin informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve punë nga momenti i administrimit të kërkesës së paraqitur me shkrim nga Korporata e Investimeve Shqiptare, dhe nuk duhet të kryejnë veprime, që mund të ndryshojnë statusin juridik të pronave, objekt zhvillimi, deri në hartimin e projekteve të zhvillimit nga Korporata e Investimeve Shqiptare për zonat/njësitë territoriale, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare i paraqet ministrisë përgjegjëse për ekonominë një raport të detajuar lidhur me përmbushjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, institucionet/entet publike, që kanë në përgjegjësi administrimi pronat shtetërore, objekt zhvillimi, institucionet e specializuara të planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



Shtojca nr. 1

LISTA E ZONAVE/NJËSIVE TERRITORIALE PËR KONSOLIDIMIN E PRONËS
SHTETËRORE NGA KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE

Nr.	Vendndodhja	Njësia strukturore e vendndodhjes për pronat me status juridik “shtet”
1	Bashkia Vlorë (Vlorë)	VL.UB.4.993 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
2	Bashkia Vlorë (Vlorë)	VL.UB.5.1263 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
3	Bashkia Vlorë (Vlorë)	VL.UB.5.1406 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
4	Bashkia Vlorë (Vlorë)	VL.UB.5.1407 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
5	Bashkia Vlorë (Vlorë)	VL.UB.5.1408 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
6	Bashkia Sarandë (Sarandë)	SA.N.253 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
7	Bashkia Sarandë (Sarandë)	SA.UB.5.166 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
8	Bashkia Durrës (Katund i ri)	DR_U_U2_236/1 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
9	Bashkia Durrës (Katund i ri)	DR_U_U2_236/2 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
10	Bashkia Durrës (Katund i ri)	DR_N_N1_189/2 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
11	Bashkia Durrës (Durrës)	DR_UB_IE1_627/26 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
12	Bashkia Durrës (Durrës)	DR_UB_IS2_627/17 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
13	Bashkia Durrës (Durrës)	DR_UB_IS2_627/16 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
14	Bashkia Durrës (Durrës)	DR_UB_IE1_627/14 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
15	Bashkia Kavajë (Golem)	G1-N5-01 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
16	Bashkia Kavajë (Golem)	G1-N5-02 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
17	Bashkia Divjakë (Divjakë)	DJ_B_EB_1 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
18	Bashkia Divjakë (Divjakë)	DJ_B_EB_2 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
19	Bashkia Divjakë (Divjakë)	DJ_N_NAR_1 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
20	Bashkia Divjakë (Divjakë)	DJ_B_B_1 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
21	Bashkia Divjakë (Divjakë)	DJ_B_B_3 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
22	Bashkia Divjakë (Divjakë)	DJ_B_IB_1 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
23	Bashkia Tiranë (Njësia 7)	TR/395 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
24	Bashkia Tiranë (Njësia 7)	TR/393 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
25	Bashkia Tiranë (Njësia 7)	TR/396 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
26	Bashkia Tiranë (Njësia 7)	TR/497 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)
27	Bashkia Tiranë (Njësia 7)	TR/404 (pa përfshirë pronat në pronësi të njësive vendore)

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 18, datë 11.7.2025**

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE
TË MATURËS SHTETËRORE 2025 DHE
TË MATURËS SHTETËRORE
PROFESIONALE 2025**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 51 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2025, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|-----------------------------|-----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 19 gusht 2025; |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 22 gusht 2025; |
| c) Matematikë | 26 gusht 2025; |
| ç) Provimi me zgjedhje | 2 shtator 2025. |

2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|---|-----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 19 gusht 2025; |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 22 gusht 2025; |
| c) Matematikë | 26 gusht 2025; |
| ç) Provimi i teorisë
profesionale të integruar | 2 shtator 2025. |

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2025 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2025 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni i dytë:

- | |
|--|
| a) Fillojnë në orën 10:00; |
| b) Zgjasin 2 orë e 30 minuta; |
| c) Testet hartohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). |

5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2025 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni i dytë, marrin pjesë:

a) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2025 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni i parë.

b) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2024–2025 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 6 gusht 2025.

c) Maturantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2025, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale në vitin 2025, sesioni i parë.

ç) Maturantët/kandidatët që kanë kryer njohjen dhe njësimin e diplomës së arsimit të mesëm të lartë dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025.

6. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi të regjistrohesh në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën që u cakton zyra vendore e arsimit parauniversitar (ZVAP).

7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi, të plotësojnë formularin AIZ, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë.

8. Maturantët/kandidatët me aftësi të kufizuara do të zhvillojnë provimet e Maturës Shtetërore bazuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 49, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 31 dhe 31/1 të Rregullores së Maturës Shtetërore.

9. Bazuar në memorandumit e bashkëpunimit/mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Italisë, për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, provimi “Gjuhë dhe letërsi italiane”:

a) Përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe dorëzohet në QSHA;

b) Zhvillohet me gojë, në shkollë më datë 18.8.2025;

c) Zhvillohet me shkrim në mjedisin e provimit të Maturës Shtetërore, më datë 19.8.2025;

ç) Rezultati i provimit gjuhë e huaj (D3) llogaritet sipas përcaktimeve të memorandumit të bashkëpunimit/mirëkuptimit, të përmendur në këtë pikë.

10. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar dërgon zyrtarisht në ZVAP, listën e maturantëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2025 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore



Profesionale 2025, sesioni i dytë, deri më datë 11 gusht 2025. Drejtori i ZVAP-së ta dërgojë këtë listë në QSHA, më datë 12 gusht 2025.

11. Provimet të zhvillohen të përqendruara. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) përcakton qendrat e provimeve, duke u bazuar në numrin e maturantëve dhe në largësinë nga qendra e provimit.

12. ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare të marrin masa për njoftimin e maturantëve për qendrën, datat dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2025 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni i dytë.

13. Drejtori i AKAP-së, brenda datës 9 gusht 2025, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe MAS-in, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2025, sesioni i dytë, dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2025 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni i dytë.

14. Monitorimi i procesit të Maturës Shtetërore 2025 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MAS-it dhe të institucioneve të varësisë.

15. Shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it për monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2025 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025, sesioni i dytë, të mbulohen nga institucionet ku janë të punësuar.

16. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

UDHËZIM Nr. 19, datë 28.7.2025

PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË TË SESIONIT TË DYTË, VITI SHKOLLOR 2024–2025

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, të sesionit të dytë, për vitin shkollor 2024–2025, të zhvillohen në datat si më poshtë:

- a) lënda “Gjuhë shqipe” më 20 gusht 2025;
- b) lënda “Matematikë” më 25 gusht 2025;
- c) lënda “Gjuhë e huaj” e parë më 29 gusht 2025;
- d) lënda “Gjuhë amtare”, për nxënësit e pakicave kombëtare, më 21 gusht 2025.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare vlerësohen në lëndët: “Gjuhë amtare”, “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe sipas dëshirës edhe në një gjuhë të huaj.

3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 74, datë 15.2.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”.



4. Gjuhët e huaja që do të jepen si provim i detyruar janë: “Anglisht”, “Frëngjisht”, “Italisht” dhe “Gjermanisht”. Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me gjuhën, e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

6. Çdo provim kombëtar i arsimit bazë fillon në orën 10:00 dhe zgjat 2 orë e 30 minuta.

7. Nxënësit me aftësi të kufizuara, që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare të arsimit bazë, sipas përcaktimeve në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë.

8. Drejtuesi i institutit të nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi” e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *Braille*.

9. Çdo zyrë vendore e arsimit parauniversitar merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar, në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe në QSHA.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani

URDHËR

Nr. 482, datë 31.7.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 1.8.2025–15.8.2025, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Tedi Dobi.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Tedi Dobi, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR

Nr. 483, datë 31.7.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 18.8.2025–25.8.2025, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.



2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

VENDIM
Nr. 36, datë 4.6.2025

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.5.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 32 (Sh) 2024, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “MARLEN” SH.P.K., e përfaqësuar nga administratori Muharrem Shutina.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

BASHKIA TIRANË, e përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Alban Dokushi.

AVOKATURA E SHTETIT, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.3.2024, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, shoqërisë “Marlen” sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është person juridik, me objekt veprimtarie importin, eksportin e të gjitha mallrave dhe ndërtimin në të gjitha fushat.

2. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë (*KRRT-ja*), me vendimin nr. 235, datë 28.5.2004, ka miratuar kërkesën për shesh ndërtimi për subjektin ndërtues, shoqërinë “Iliada” sh.p.k., në pronën e familjes Kika në qytetin e Tiranës. Me vendimin nr. 297, datë 5.7.2004, KRRT-ja ka miratuar lejen e ndërtimit po për këtë subjekt ndërtues për një godinë banimi 2, 6 dhe 8 kate në rrugën “Muhamet Gjollësja”, Tiranë.

3. Midis kërkuases, në cilësinë e investitorit, dhe shoqërisë “Iliada” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrëses, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. 15621 rep., nr. 3270 kol., datë 11.12.2004, për kalimin e investimit, si dhe kontrata nr. 7289 rep., nr. 1807 kol., datë 10.6.2006, për kalimin e sipërmarrjes në favor të kërkuases. Sipas kontratës së fundit, kërkuesja ka marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit, individëve dhe pronarëve të truallit ku do të kryhej ndërtimi.

4. Në zbatim të lejes së ndërtimit është nxjerrë autorizimi nr. 5161 prot., datë 10.6.2005 nga drejtoria e përgjithshme e urbanistikës në Bashkinë Tiranë, për pagesën e taksës 5% të ndikimit në infrastrukturë, e cila është paguar me mandat bankar nr. 000TRFRO51640010, datë 13.6.2005, në shumën 7.200.000 lekë. Pas pagesës së taksës prej 5% është miratuar leja për prishje ndërtimi nr. 4236 prot., datë 17.5.2005 dhe është zbardhur formulari nr. 4 për lejen e ndërtimit nr. 4236/ 1 prot., datë 17.5.2005.



5. Pas kërkesës së shoqërisë “Marlen” sh.p.k., KRRT-ja, me vendimin nr. 229, datë 12.10.2008, ka miratuar shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit edhe për 36 muaj, deri në datën 12.10.2011.

6. Disa prej pronarëve të truallit, ku do të realizohej ndërtimi, kanë paraqitur padi për pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 297, datë 5.7.2004, të KRRT-së, “Për lejen e ndërtimit”, si dhe të vendimit nr. 229, datë 12.10.2008, të KRRT-së, “Për zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimit”, me pretendimin se leja e ndërtimit ishte marrë në kundërshtim me ligjin. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9731, datë 1.12.2011, ka vendosur pranimin e padisë. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi me vendimin nr. 722, datë 26.3.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar rekursin e ushtruar nga kërkuuesja dhe kundërrekursin e paditësve/pronarëve të truallit, me vendimin nr. 00-2017-389 (203), datë 4.4.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Në rrethanat kur së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimi nuk ishte depozituar kopja e formularit nr. 4 të lejes së ndërtimit, KRRT-ja ka marrë vendimin nr. 4236 prot., datë 17.5.2005, “Për prishjen e ndërtimit”. Në vijim, kërkuuesja i është drejtuar Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) në Bashkinë Tiranë për të ndërhyrë për lirin e sheshit të ndërtimit. INUV-i, me shkresat nr. 2001 prot., datë 27.2.2009 dhe nr. 5231 prot., datë 5.6.2009, ka lajmëruar për prishjen e objektit. Në datën 15.6.2009 është kryer prishja e banesave vetëm të personave që kishin nënshkruar kontratën e sipërmarrjes përfundimtare, të cilët kishin rënë dakord për prishjen e banesave të tyre, duke lënë pa prishur banesat e tjera, pronarët e të cilave nuk kishin nënshkruar ende kontratat përfundimtare të sipërmarrjes.

8. Kërkuuesja ka pretenduar se drejtoria e urbanistikës në Bashkinë Tiranë nuk i ka vendosur në dispozicion formularin nr. 4 të lejes së ndërtimit në mënyrë që të fillonte punimet. Për këtë arsye, kërkuuesja/paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të detyruar Bashkinë Tiranë për ta pajisur me formularin nr. 4 për zbardhjen e lejes së ndërtimit nr. 4236/1 prot., datë 17.5.2005, për të filluar punimet. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3642, datë

16.4.2012, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë për të pajisur kërkuuesen me formularin nr. 4 për zbardhjen e lejes së ndërtimit nr. 4236/1 prot., datë 17.5.2005. Gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar kërkimin për rivendosjen në afat të lejes së ndërtimit. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 30.5.2012, por Bashkia Tiranë nuk e ka ekzekutuar edhe pas realizimit të procedurave të ekzekutimit nga një shoqëri përmbartimore private.

9. Kërkuuesja i është drejtuar disa herë drejtorisë së urbanistikës në Bashkinë Tiranë për t’u pajisur me formularin nr. 4 të zbardhjes së lejes së ndërtimit, por nuk ka marrë përgjigje. Formulari nr. 4 duhej të ishte pjesë e kontratave përfundimtare të sipërmarrjes, me anë të të cilave pronarët e truallit do të firmosnin për pjesën takuese në ndërtimin e ri.

10. Në datën 17.9.2020 kërkuuesja i është drejtuar drejtorisë së përgjithshme të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tiranë, duke kërkuar kthimin e shumës 7.200.000 lekë, që përfaqësonte taksën e ndikimit në infrastrukturë për lejen e ndërtimit nr. 297, datë 5.7.2004, të KRRT-së. Drejtoria e përgjithshme e taksave dhe tarifave vendore, me shkresën nr. 7271/1 prot., datë 6.10.2020, të sektorit të kontabilitetit (*shkresa nr. 7271/1 prot., datë 6.10.2020, e Bashkisë Tiranë*), e cila i është njoftuar kërkuueses në datën 10.10.2020, i ka kthyer përgjigje se referuar shkresës nr. 35625/1, datë 7.11.2019, të drejtorisë së ankimeve pranë drejtorisë së përgjithshme juridike të aseteve dhe licencimit të Bashkisë Tiranë është refuzuar kërkesa për kthimin e shumës së paguar për nxjerrjen e lejes së ndërtimit për arsye se me vendimin nr. 9731, datë 1.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është konstatuar pavlefshmëria absolute e lejes së ndërtimit dhe gjykata nuk është shprehur për rregullimin e pasojave (*shih paragrafin 6 të këtij vendimi*).

11. Kërkuuesja ka pretenduar se duke mos iu kthyer shuma e paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë i është shkaktuar dëm efektiv. Në datën 17.11.2020 kërkuuesja i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me padi për detyrimin e Bashkisë Tiranë/palë e paditur për kthimin e shumës së paguar për taksën 5% të ndikimit në infrastrukturë të paguar për lejen e ndërtimit nr. 297, datë 5.7.2004, për godinën e banimit me 2, 6 dhe 8 kate në rrugën “Muhamet Gjollesha”, Tiranë, dhe shpërblimin e dëmit efektiv të shkaktuar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit dhe të



kontratave të sipërmarrjes dhe të porosive me pronarët e truallit, në shumën totale 50.427.766 lekë. Detyrimin e Bashkisë Tiranë që t'i paguajë kërkukses kamatëvonesat ligjore për dëmin efektiv në shumën totale 17.945.553 lekë dhe pagesat mujore të qirave në shumat 50.000 lekë në muaj, si dhe 1.200 USD në muaj nga data 17.6.2021 deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

12. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3207 (80-2021-3261), datë 16.11.2021, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë dhe detyrimin Bashkisë Tiranë që të dëmshpërblejë kërkuksen/palë paditëse në vlerën e dëmit pasuror, si dhe fitimin e munguar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit nr. 297, datë 5.7.2004 dhe kontratave të sipërmarrjes dhe porosive me pronarët e truallit në vlerën totale të dëmit 68.373.319 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë. Rrëzimin e padisë për sa i përket pjesës tjetër të kërimit, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se e drejta e padisë në rastin konkret ka lindur në zbatim të nenit 18/1 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), pra brenda 45 ditëve nga dita kur ka marrë përgjigjen përfundimtare nga Bashkia Tiranë për moskthimin e shumës së taksës së paguar me shkresën e njoftuar në datën 10.10.2020, për rrjedhojë padia e datës 17.11.2020 është depozituar brenda afatit ligjor 45-ditor në gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërimit për kamatëvonesat që buronin nga dëmi i shkaktuar.

13. Pas ankimit të subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 435 (86-2023-626), datë 30.5.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit ka arsyetuar se padia në këtë rast nuk parashkruhet, pasi është aksesore me padinë për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit, të zgjidhur me vendim gjyqësor që e ka pranuar atë padi. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se, në rastin konkret, pala e paditur detyrohet të kthejë shumën e përfituar prej saj dhe të paguar nga pala paditëse/kërkuksja për dhënien e lejes së ndërtimit bazuar në parimin e rivendosjes së palëve në gjendjen e mëparshme. Sipas gjykatës së apelit, pala paditëse/kërkuksja ka humbur të drejtën

për ndërtim, prandaj duhet t'i kthehen shumat që ka paguar, si dhe kamatëvonesat përkatëse (*shih faqen 12 të vendimit të gjykatës së apelit*).

14. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit bazuar në nenin 5, pika 1/1, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit". Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.3.2024, ka ndryshuar vendimin nr. 435 (86-2023-626), datë 30.5.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimin nr. 3207 (80-2021-3261), datë 16.11.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se nga data 12.10.2011, kohë kur ka përfunduar afati për shtyrjen e lejes së ndërtimit, pala paditëse/kërkuksja nuk mund të vazhdonte me ndërtimin dhe e ka pasur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e dëmit të shkaktuar nga pamundësia e realizimit të ndërtimit dhe të organit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin e pretenduar, që lidhet me mosdorëzimin e formularit nr. 4, për të cilin pretendon se ishte në pritje. Nga momenti që Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 722, datë 26.3.2013, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të lejes, pala paditëse nuk ka pasur më dyshime për pamundësinë e vazhdimin të këtij ndërtimi. Në këtë kuptim, pala paditëse ka qenë në dijeni të dëmit të shkaktuar dhe se cili ishte organi publik që duhet të vepronte, por që nuk ka vepruar, sipas pretendimit të saj, në mënyrë të paligjshme dhe, për pasojë pala paditëse nuk ka paraqitur padinë brenda afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga Kodi Civil (KC) dhe ligji nr. 49/2012.

15. Në datën 31.10.2024 kërkuksja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 4.11.2024. Në datën 15.1.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 29.1.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. **Kërkuksja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:



16.1. *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë, duke vendosur rrëzimin e padisë, ka mohuar të drejtën për të marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara. Kërkimi i Bashkisë Tiranë se padia është parashkuar, është ngritur vetëm në konkluzionet përfundimtare gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke argumentuar se padia është depozituar jashtë afatit ligjor 45-ditor të parashkuar në ligjin nr. 49/2012 dhe nuk është i referuar në asnjë moment afatit ligjor 3-vjeçar të parashkuar nga ligji nr. 8510, datë 15.7.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” (ligji nr. 8510/1999). Referuar nenit 158, pika 7, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), Gjykata e Lartë e ka anashkuar dhe nuk është shprehur për këtë dispozitë, pasi, në rastin konkret, prapësimet dhe provat nuk janë paraqitur së bashku me deklaratën e mbrojtjes, për rrjedhojë nuk duhet të ishin pranuar nga gjykata në pretendimet përfundimtare. Mosshqyrtimi i nenit 158 të KPC-së nga gjykatat më të ulëta duhej të konsiderohej nga Gjykata e Lartë si shkelje procedurale, për rrjedhojë rekursi nuk duhej të pranohej. Gjykata e Lartë për parashkrimin i është referuar vendimit nr. 722, datë 26.3.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, por nga ana tjetër ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs, për të cilin Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2017-389 (203), datë 4.4.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit (vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i aksesueshëm në datën 4.12.2017). Nëse Gjykata e Lartë do t’i referohej këtij vendimi, kërkuesja përsëri do të ishte brenda afatit ligjor 3-vjeçar për paraqitjen e padisë. Komunikimi i shkresës nr. 7271/1 prot., datë 6.10.2020 të Bashkisë Tiranë pas më shumë se 1 viti nuk i ka hequr kërkueses të drejtën për të ngritur padi dhe kërkimi është bërë brenda afatit ligjor 3-vjeçar. Kërkuesja nuk mund të kërkonte gjyqësisht kthimin e shumës, pa marrë më parë përgjigje përfundimtare nga Bashkia Tiranë. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3642, datë 16.4.2012, ka vendosur detyrimin e Bashkisë Tiranë për të pajisur kërkuesen me formularin nr. 4 për zbardhjen e lejes së ndërtimit, vendim që kjo bashki pa asnjë shkak nuk e ka ekzekutuar. Pavarësisht të gjitha vendimeve, ka qenë vendimi nr. 200, datë 15.6.2020 i gjykatës së apelit (që ka vendosur pranimin e padisë të disa prej pronarëve të truallit për kundërshtimin e procedurave të ekzekutimit në

zbatim të vendimit gjyqësor që i detyronte ata për të paguar detyrimet sipas kontratave të sipërmarrjes), që i ka shuar kërkueses shpresat për të zhvilluar lejen e ndërtimit dhe për këtë arsye Gjykata e Lartë duhet të kishte marrë në konsideratë edhe këtë datë për llogaritjen e afatit ligjor 3-vjeçar, sipas ligjit nr. 8510/1999, për padinë e datës 17.11.2020.

16.2. *E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e drejta e pronës, siguria juridike dhe pritshmëritë e ligjshme*, pasi është cenuar e drejta e pronës e garantuar në nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Gjykata e Lartë, duke vepruar tej kompetencave të saj, ka cenuar të drejtën e pronës, pra vlerën monetare që kërkuesja priste të kompensohej (dëmshpërblehej), duke humbur mjetet monetare dhe të ardhurat nga leja e ndërtimit.

17. Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, ka prapësuar, si vijon:

17.1. *Pretendimet e kërkueses janë të pabazuara*, pasi nga data 12.10.2011, kohë kur ka përfunduar afati i shtyrë i lejes së ndërtimit, kërkuesja nuk mund të vazhdonte me ndërtimin. Ajo ka pasur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e dëmit të shkaktuar nga pamundësia e realizimit të ndërtimit dhe të organit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin e pretenduar, që lidhet me mosdorëzimin e formularit nr. 4. Nga momenti që Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 722, datë 26.3.2013, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit, kërkuesja ka qenë në pamundësi për vazhdimin e ndërtimit. Shkresa nr. 7271/1 prot., datë 6.10.2020 e Bashkisë Tiranë, me anë të së cilës kërkueses i është komunikuar shkresa e drejtorisë së përgjithshme juridike e aseteve dhe licencimit se është refuzuar kërkesa për kthimin e shumës, nuk e pezullon dhe as nuk e ndërpret afatin e parashkrimit. Shkresa nr. 7271/1 prot., datë 6.10.2020 e Bashkisë Tiranë nuk është akt administrativ që mund të kundërshtohet në gjykatë brenda afatit ligjor 45-ditor. Marrëdhënia juridike mes palëve për shpërblimin e dëmit ka lindur nga momenti që pala e paditur/Bashkia Tiranë ka kryer veprime ose mosveprime të paligjshme në vitin 2011. Nisur nga ky vit, kur ka mbaruar afati i lejes së ndërtimit, por edhe nga viti 2013, kur gjykata e ka konstatuar të pavlefshme lejen e ndërtimit deri në datën 17.11.2020, kur është paraqitur padia, kanë kaluar më shumë se 3 vjet, pra dukshëm më shumë se afati ligjor për paraqitjen e padisë.



18. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkujes

19. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkujesja legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

21. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, kërkujesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka disponuar për vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta që kanë pranuar padinë e kërkujeses, duke vendosur ndryshimin e këtyre vendimeve dhe rrëzimin e padisë, ndaj Gjykata çmon se kërkujesja i ka shteruar mjetet juridike efektive dhe se nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

22. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit

kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, mban datën 25.3.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 31.10.2024. Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 2.7.2024, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

23. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkujesja ka parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit, gjykatës së caktuar me ligj, sigurisë juridike e pritshmërive të ligjshme, si dhe të së drejtës së pronësisë, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Kërkujesja, në mënyrë të përmblodhur, ka parashtruar se Gjykata e Lartë ka mohuar të drejtën për të marrë përgjigje për kërkimin për kthimin e shumës së paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për afatet e parashkrimit të padisë ka qenë i gabuar, duke cenuar të drejtën e kthimit të taksës dhe të shpërblimit të dëmit të pësuar.

24. Për sa më lart, Gjykata vlerëson ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në vlerësimin e së drejtës së pronës së kërkujeses, Gjykata evidenton se taksa është pjesë e konceptit kushtetues të pronës, pasi pagesa e një sasive të caktuar të hollash, e barasvlershme me masën e detyrimit, është një shumë e cila merret nga pasuria e individit tatimpagues, që vetë atij i buron nga ligji për të paguar detyrimet financiare (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa më lart, për të përcaktuar nëse kërkujeses i është cenuar e drejta e pronës, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi gjyqësor i zhvilluar nga Gjykata e Lartë, që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, ka përmblusur standardet e procesit të rregullt ligjor në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

*B. Për themelin e pretendimeve**B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*

26. Kërkuesja ka pretenduar se nga Bashkia Tiranë, si palë e paditur në gjykim, nuk është parashtruar kërkimi për paraqitjen e padisë tej afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8510/1999. Për më tepër, paraqitja e këtij kërkimi tej parashtrimeve të deklaratës së mbrojtjes është në kundërshtim me nenin 158 të KPC-së dhe nga Gjykata e Lartë duhej të konsiderohej si shkelje e rëndë procedurale. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara nga kërkuesja dhe komunikimi i shkresës nr. 7271/1 prot., datë 6.10.2020, të Bashkisë Tiranë, pas më shumë se 1 viti, nuk i ka hequr të drejtën për të ngritur padi brenda afatit ligjor 3-vjeçar. Në drejtim të plotësimit të afatit ligjor, Gjykata e Lartë duhej të merrte parasysh edhe vendimin nr. 200, datë 15.6.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

27. Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, ka prapësuar se nga data 12.10.2011, kohë kur ka përfunduar afati i shtyrjes së lejes së ndërtimit, kërkuesja nuk mund të vazhdonte më ndërtimin. Ajo e ka pasur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e dëmit të shkaktuar nga pamundësia e realizimit të ndërtimit, si dhe të organit përgjegjës për shkaktimin e dëmit të pretenduar, që lidhet me mosdorëzimin e formularit nr. 4 për zbardhjen e lejes së ndërtimit. Bashkia Tiranë ka parashtruar se shkresa nr. 7271/1 prot., datë 6.10.2020, e lëshuar nga ai institucion nuk është akt administrativ që mund të kundërshtohet në gjykatë brenda afatit ligjor 45-ditor.

28. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur duhet bërë

arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuesja ka marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara nga ajo gjatë gjykimit të çështjes, si dhe nëse ato janë vlerësuar nga Gjykata e Lartë në kuadër të garancive që ofron neni 42 i Kushtetutës për procesin e rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja në datën 13.6.2005 ka paguar shumën 7.200.000 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë, që përfaqësonte vlerën 5 % të investimit. Kjo taksë është paguar bazuar në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, "Për urbanistikën", të ndryshuar dhe vendimin nr. 7, datë 7.3.2003, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" të këshillit bashkiak Tiranë. Sipas këtyre akteve, taksa e ndikimit në infrastrukturë synon të balancojë dëmin që vjen në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Ajo paguhet nga personi juridik përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit. Si bazë e kësaj takse është vlera e investimit të ri që kërkohet të kryhet dhe vlera e taksës shprehet si përqindje ndaj vlerës së investimit. Mbi bazën e këtij kuadri ligjor, Gjykata konstaton se vlera e paguar nga kërkuesja për taksën e ndikimit në infrastrukturë ka qenë e kushtëzuar me marrjen e lejes së ndërtimit dhe vlerën e investimit. Megjithatë, kërkuesja nuk është pajisur nga Bashkia Tiranë me dokumentin e lejes së ndërtimit dhe kjo e fundit në vitin 2011 me vendim gjyqësor është shpallur si akt absolutisht i pavlefshëm. Në këto rrethana, në muajin shtator të vitit 2020 kërkuesja i ka kërkuar Bashkisë Tiranë kthimin e shumës së paguar për atë taksë, por kjo bashki e ka refuzuar kërkesën me argumentin se vendimi gjyqësor për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit nuk është shprehur për rregullimin e pasojave.

31. Në nëntor të vitit 2020 kërkuesja u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat gjatë procesit gjyqësor kanë marrë në shqyrtim padinë, me objekt kthimin e shumës së paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe shpërblimin



e dëmit jashtëkontraktor. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3207 (80-2021-3261), datë 16.11.2021, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë/palë e paditur për të dëmshpërblyer kërkuuesen në vlerën e dëmit pasuror, si dhe fitimit të munguar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit nr. 297, datë 5.7.2004 dhe kontratave të sipërmarrjes dhe porosive me pronarët e truallit në vlerën totale të dëmit 68.373.319 lekë, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërimit për kamatëvonesat, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se në rastin konkret plotësohen kushtet për ekzistencën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga veprimi i paligjshëm dhe me faj i të tretit sipas neneve 608 dhe 609 të KC-së dhe vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në rastin konkret, në referim të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve nga dita kur ka marrë përgjigje përfundimtare nga Bashkia Tiranë për moskthimin e taksës me shkresën e kësaj bashkie, e cila është komunikuar në datën 10.10.2020.

32. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 435 (86-2023-626), datë 30.5.2023, pas ankimit të subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se, në rastin konkret, pala e paditur detyrohet të kthejë shumën e përfituar prej saj dhe të paguar nga pala paditëse/kërkuuesja për lëshimin e lejes së ndërtimit. Për afatin e parashkrimit, gjykata e apelit ka arsyetuar se padia nuk parashkruhet, pasi është e lidhur me padinë për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit. Sipas gjykatës së apelit, pala paditëse/kërkuuesja ka humbur të drejtën për ndërtim, por kjo nuk i shuan të drejtën për të kërkuar kthimin e asaj që ka paguar (*shih paragrafin 13 të këtij vendimi*).

33. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.3.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 435 (86-2023-626), datë 30.5.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimit nr. 3207, datë 16.11.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së

Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë. Në vendim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se në rastin konkret janë përpara padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, padi civile, e cila duhet të paraqitet brenda afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga ligji i posaçëm nr. 8510/1999. Sipas Kolegjit Administrativ, edhe në nenin 115, shkronja “dh”, të KC-së parashikohet afati ligjor 3-vjeçar për parashkrimin e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor.

34. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se momenti i lindjes të së drejtës së padisë përcaktohet si momenti i fillimit të ecjes së afatit të parashkrimit, pasi vetëm me lindjen e kësaj të drejte mund të flitet për mosveprim të titullarit dhe vetëm kur cenohet e drejta subjektive lind e drejta e padisë për mbrojtjen e saj. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se momenti kur kërkuueses i ka lindur e drejta për të paraqitur padi ka qenë data 12.10.2011, kur ka përfunduar afati për shtyrjen e lejes së ndërtimit. Në vijim, pala paditëse/kërkuuesja nuk mund të vazhonte me ndërtimin dhe se ajo e ka pasur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e dëmit të shkaktuar nga pamundësia e realizimit të ndërtimit dhe të organit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin e pretenduar dhe jo nga data 10.10.2020 kur i është komunikuar shkresa e Bashkisë Tiranë. Gjithashtu, sipas Kolegjit Administrativ, kjo shkresë nuk përbën akt administrativ, që mund të kundërshtohet në gjykatë brenda 45 ditëve dhe se nuk përbën shkak për të pezulluar ose ndërprerë ecjen e afatit të parashkrimit. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se, në rastin konkret, për të ngritur padinë e kërimit të shpërblimit të dëmit, si në ligjin e posaçëm, ashtu edhe në KC, parashikohet afati ligjor 3-vjeçar, i cili pranohet edhe nga referimi që bëhet në nenin 18, pika 4, të ligjit nr. 49/2012. Nga ana tjetër, specifika e gjykimit administrativ është se në pikën 7 të kësaj dispozite gjendet rregullimi se afatet e parashkrimit janë të prera dhe shkelja e tyre shkaktonte humbjen e së drejtës së padisë, si dhe *“këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kyesisht”*. Pra, sipas Gjykatës së Lartë, ligji i posaçëm nr. 49/2012, në nenin 18, pika 7, të tij, ka vendosur një rregull të ndryshëm nga ai i parashikuar në nenin 125 të KC-së, dhe se gjen zbatim ekskluzivisht për gjykimet administrative dhe lidhet me mundësinë dhe detyrimin e gjykatës administrative që të marrë parasysh vetë afatin e parashkrimit, edhe pa u ngritur kjo çështje nga palët,



duke vlerësuar se në rastin konkret padia është paraqitur jashtë afatit ligjor.

35. Duke analizuar përmbajtjen e vendimeve gjyqësore në raport me rrethanat e çështjes, Gjykata konstaton se padia e paraqitur nga kërkuesja ka pasur dy kërkime të ndryshme, me objekte dhe shkaqe të ndryshme, konkretisht: 1) kthimin e shumës 7.200.000 lekë të paguar për taksën 5 % të ndikimit në infrastrukturë për lejen e ndërtimit nr. 297, datë 5.7.2004, për godinën 2, 6 dhe 8 kate në rrugën “Muhamet Gjollësja”, Tiranë, për shkak se ndërtimi nuk ishte realizuar; 2) shpërblimin e dëmit të shkaktuar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit dhe të kontratave të sipërmarrjes, si dhe porositve me pronarët e truallit dhe fitimin e munguar. Pas shqyrtimit të padisë nga gjykata e shkallës së parë, e cila ka çmuar se padia ishte paraqitur brenda afatit ligjor, duke përcaktuar vlerën 68.373.319 lekë për shpërblimin e dëmit pasuror dhe fitimin e munguar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit dhe të kontratave të sipërmarrjes, gjykata e apelit dhe, në vijim, Gjykata e Lartë kanë shqyrtuar ankimin dhe rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, duke i vlerësuar pretendimet dhe duke mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta. Konkretisht, gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkimi për kthimin e taksës ishte kërkim aksesori i padisë për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit, e cila nuk parashkruhet, ndaj edhe për kthimin e taksës nuk zbatohej ndonjë afat parashkrimi. Ndërsa për detyrimin e Bashkisë Tiranë për të dëmshpërblyer kërkuesen, gjykata e apelit ka arsyetuar se në interpretim të nenit 450 të KC-së shpërblimi për dëmin duhet të rrjedhë nga vonesa e debitorit, pra lind nga momenti kur detyrimi është bërë i kërkueshëm për debitorin dhe ai nuk e ka përmbushur atë (*shih faqen 12 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

36. Ndërsa Gjykata e Lartë i ka vlerësuar të dyja kërkimet e padisë si një të vetme në drejtim të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor dhe ka marrë në shqyrtim kryesisht parashkrimin e padisë sipas afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8510/1999 për shpërblimin e dëmit. Lidhur me marrjen në shqyrtim të parashkrimit me nismën e saj, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ligji nr. 49/2012 ka përparësi ndaj parashkrimit të nenit 125 të KC-së, sipas të cilit parashkrimi i plotësuar nuk mund të merret parasysh nga gjykata ose organi tjetër

kompetent me nismën e vet, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke përdorur metodën e interpretimit *strictu sensu* të ligjit nr. 49/2012, ka arsyetuar se kërkuesja ka qenë në dijeni të dëmit të pësuar dhe të subjektit (organit publik) që e ka shkaktuar atë, duke plotësuar në mënyrë kumulative kriteret e nenit 120 të KC-së (*shih paragrafin 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Nuk rezulton që Gjykata e Lartë të jetë shprehur për kërkimin për kthimin e taksës së paguar dhe as se përse nuk qëndronte arsyetimi i gjykatës së apelit se ky kërkim nuk i nënshtrohej parashkrimit, pasi ishte kërkim aksesori i padisë për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit, që sipas ligjit nuk parashkruhet. Si pasojë e këtij interpretimi/zbatimi të ligjit, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe, për këtë shkak, ka ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta, duke vendosur rrëzimin e padisë.

37. Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke marrë kryesisht në shqyrtim çështjen e parashkrimit të padisë, ka vlerësuar se kërkuesja ka kërkuar dëmshpërblim tej afatit ligjor 3-vjeçar, duke rrëzuar në tërësi padinë e saj. Edhe pse gjykata e apelit ishte shprehur se kërkimi për kthimin e taksës së infrastrukturës nuk parashkruhej, duke mbajtur në konsideratë se ishte kërkim aksesori i lidhur me procesin gjyqësor për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të lejes së ndërtimit, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse ky arsyetim ishte i pabazuar, por ka zgjedhur të mos shprehet fare për këtë kërkim, ndonëse kërkuesja kishte paguar taksën në favor të bashkisë për një ndërtim, i cili *de facto* nuk u realizua. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim vetëm për njërin nga kërkimet e parashtruara në padi, për shpërblimin e dëmit të shkaktuar për shpenzimet e kryera nga kërkuesja dhe nuk ka dhënë asnjë përgjigje për kërkimin tjetër të saj për kthimin e shumës së paguar për taksën 5% të ndikimit në infrastrukturë. Në këtë mënyrë, pretendimi i kërkueses për kthimin e shumës 7.200.000 lekë nuk ka marrë përgjigje përfundimtare nga gjykatat, që do të thotë se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji, duke mos mbajtur qëndrim të shprehur për kërkimin për kthimin e shumës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas objektit të padisë të kërkueses, ka cenuar të drejtën e aksesit substancial të lidhur me standardin kushtetues të



arsyetimit të vendimit gjyqësor, për rrjedhojë pretendimi në këtë drejtim është i bazuar. Në kushtet kur procesi i zhvilluar nga Gjykata e Lartë, për pjesën për kërkimin për kthimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë, nuk ka përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor, Gjykata çmon se është vënë në dyshim edhe e drejta e pronës së kërkueses.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses është e pjesërisht e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.3.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm për kërkimin për kthimin e shumës së paguar si taksë e ndikimit në infrastrukturë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 4.6.2025.

Shpallur më 31.7.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini

URDHËR

Nr. 201, datë 29.7.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; germave “b” dhe “ç”, të nenit 13, dhe germës “a”, të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 7, dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 30, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit të znj. Alketa Çeli, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të kryer procedurat administrative dhe nënshkruar aktet që lidhen me përpunimin tekniko-shkencor të dokumentacionit arkivor të Kolegjit, sipas legjislacionit në fuqi.
 2. Znj. Alketa Çeli nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
 3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.
 4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo

URDHËR

Nr. 215, datë 1.8.2025

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 21, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të



Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të lejes vjetore të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Alketa Çeli, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për periudhën 4.8.2025 deri më 20.8.2025.

2. Znj. Alketa Çeli nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë

